



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

**DRAFT NDRYSHIMI DHE PLOTËSIMI I RREGULLORES,
01.nr.110-2782, më 2.12.2011, PËR TARIFA, NGARKESA DHE GJOBA
KOMUNALE**

Prishtinë, 2026

Në mbështetje të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika c, dhe nenit 40, paragrafi 40.2, pika a të Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008) dhe të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, shkronja c e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, më....., miratoi këtë:

DRAFT NDRYSHIMI DHE PLOTËSIMI I RREGULLORES, 01.nr.110-2782, më 2.12.2011, PËR TARIFA, NGARKESA DHE GJOBA KOMUNALE

KAPITULLI I

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Kjo Rregullore ka për qëllim përcaktimin e aktiviteteve të cilat i nënshtrohen taksës komunale brenda kufijve administrativ të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, Prishtinës (mëtej: Kryeqyteti), lartësinë e taksave komunale dhe përcaktimin e kundërvajtjeve dhe sanksioneve kundërvajtëse për shkeljet e dispozitave të kësaj Rregulloreje.

Neni 2

Fushëveprimi

Dispozitat e kësaj Rregulloreje janë të obligueshme për të gjithë personat fizik dhe juridik që nëpërmjet ndonjë aktiviteti të zhvilluar obligohen të paguajnë taksë komunale të përcaktuar me këtë Rregullore si dhe për të gjitha njësitë e Kryeqytetit që zbatojnë dispozitat e kësaj Rregulloreje.

Neni 3

Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë Rregullore kanë këto kuptime:

1.1. Taksë komunale – nënkupton shumën fikse dhe të pakthyeshme të pagesës sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje, që paguhet nga personat juridik dhe fizik autoriteteve të Kryeqytetit në mënyrën e paraparë në këtë Rregullore, në emër të:

1.2. Vit fiskal – nënkupton periudhën nga data një (1) janar deri më datën tridhjetë e një (31) dhjetor të të njëjtit vit;

1.3. Person – nënkupton personin fizik dhe juridik;

1.4. Person fizik – nënkupton personin fizik jo afarist që nuk ka të regjistruar aktivitet biznesi; dhe personi fizik afarist që ka të regjistruar biznes në bazë të legjislacionit në fuqi dhe që zhvillon aktivitet të rregullt afarist;

1.5. Person juridik – nënkupton një shoqëri ose një organizatë tjetër biznesi që ka statusin e një personi juridik sipas legjislacionit në fuqi për shoqëritë tregtare dhe çdo legjislacion tjetër të aplikueshëm në Kosovë;

1.6. Taksa për akomodim – është tarifë komunale që paguhet për çdo natë qëndrimi nga personat që shfrytëzojnë shërbime akomodimi.

1.7. Subjekt hotelier – çdo person fizik ose juridik që ofron shërbime akomodimi (hotel, motel, hostel, bujtinë, apartament me qira ditore dhe forma të tjera të akomodimit).

KAPITULLIT II

Neni 4

Parimet e përgjithshme të taksave komunale

1. Të gjitha taksat komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste përcaktohen me këtë Rregullore.
2. Të gjitha taksat komunale për ushtrim e veprimtarisë afariste përcaktohen marrë parasysh parimin e mosdiskriminimit dhe të proporcionalitetit, sipas dispozitave ligjore në fuqi.
3. Asnjë taksë komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste që nuk është e përcaktuar me këtë Rregullore apo në ndonjë Rregullore tjetër komunale nuk mund të kërkohet që të paguhet.
4. Për ngarkimin dhe inkasimin e taksës për ushtrimin e veprimtarisë afariste përgjegjës është Sektori i zhvillimit të qëndrueshëm, i cili njëkohësisht ushtron edhe funksionin e verifikimit dhe kontrollit administrativ lidhur me zbatimin e kësaj rregulloreje.

Ndërsa për identifikimin dhe monitorimin e bizneseve në terren përgjegjëse është Drejtoria e Inspektionit, e cila kryen inspektimin e veprimtarive ekonomike, duke përfshirë kontrollin e bizneseve se a janë të pajisura me leje për ushtrim të veprimtarive afariste, sipas kësaj rregulloreje.

Në rastet kur gjatë inspektimeve në terren konstatohen parregullsi ose jepen vërejtje, Drejtoria e Inspekcionit njofton Sektorin e zhvillimit të qëndrueshëm për gjendjen faktike në teren.

5. Subjektet afariste do të ngarkohen sipas aktivitetit të ushtrimit të veprimtarisë

6. Përjashtim nga pika...biznesi do të tarifohet/ngarkohen në bazë të raportit të inspekcionit i cili konstaton veprimtarin të cilën e ushtron biznesi në teren.

Neni 5

Pagesa e taksave komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste

1. Të gjitha pagesat e taksave komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste që duhet të kryhen sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje, bëhen sipas shumave të përcaktuara në këtë Rregullore dhe paguhen në valutën euro (€).

2. Të gjitha pagesa bëhen nëpërmjet bankave apo institucioneve financiare të licencuara, në bazë të faturës të pranuar nga zyrtari përkatës komunal, përmes postes elektronike apo Postës së Kosovës, në xhirollogarinë e Komunës.

2. Sektori për zhvillim të qëndrueshëm faturimin do ta realizon më së largu deri në shtator të vitit kalendarik;

3. Subjektet afariste faturën e caktuar do ta paguajnë deri me datën 31 dhjetor të vitit kalendarik për të cilin ngarkohen, në të kundërtën lënda do të procedohet për inkasim të detyrueshëm përmes inicimit të procedurës përmbartimore;

4. Subjektet afariste faturën e pranuar brenda 30 ditësh mund ta kontestojnë me anë të ankesës drejtuar Komisionit për komunal për ankesa ndaj taksës komunale i caktuar me Vendim të Kryetarit të Kryeqytetit.

5. Subjektet afariste të cilat gjatë vitit fiskal kanë qenë pasive (deklarimet me zero) dhe nuk kanë ushtruar veprimtari, parashirojnë ankesë;

6. Shqyrtimin i ankesave kundër faturave të caktimit të taksës për ushtrimin e veprimtarive afariste do ta bëjë komisioni komunal për ankesa ndaj taksës komunale i caktuar me Vendim të Kryetarit të Kryeqytetit.

7. Subjektet afariste ngarkohen sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje duke filluar nga muaji qershor i vitit 2026. Përjashtim bëjnë bizneset që aktualisht tarifohen sipas tarifores ekzistuese; këto do të vazhdojnë të tarifohen sipas sistemit aktual deri në dhjetor 2026, dhe nga 1 janari 2027 do të zbatohen tarifat e reja.

8. Subjektet afariste që selinë e kanë në një komunë tjetër, por ushtrjnë veprimtari në territorin e Kryeqytetit përmes një njësie, do të taksohen me taksë të plotë për atë njësi.

9. Subjektet afariste që në territorin e Kryeqytetit kanë dy (2) ose më shumë njësi, do të taksohen si në vijim:

9.1.Njëra nga njësitë do të faturohet si seli themelore;

9.2.Njësitë e tjera do të faturohen si njësi të saj, sipas kategorizimit përkatës.

10. Njësitë e subjekteve afariste paguajnë 50% nga tarifa bazë.

11. Nëse aktiviteti i njësisë ndryshon nga aktiviteti i selisë themelore, atëherë kjo njësi do të faturohet me taksën e plotë të paraparë me këtë rregullore për atë aktivitet, dhe jo me 50% të tarifës bazë.

Neni 6

Pagesa e taksave, legjitimimi i veprimtarive dhe kompetencat e Kryeqytetit

1. Kryeqyteti nuk ka kompetencë për regjistrimin apo legjitimimin e subjekteve afariste.
2. Kryeqyteti nuk ka kompetencë të përcaktojë mënyrën e organizimit, formën e operimit apo mënyrën e ushtrimit të veprimtarisë së bizneseve, përveç rasteve kur kjo rregullohet shprehimisht me legjislacionin në fuqi.
- 3.Bizneset që ushtrojnë veprimtari në territorin e Kryeqytetit dhe që janë të regjistruara nga institucionet kompetente sipas legjislacionit në fuqi, obligohen të paguajnë taksën përkatëse komunale në përputhje me këtë rregullore.
- 4.Pagesa e taksës komunale nuk përbën akt regjistrimi, legjitimimi apo miratimi të mënyrës së operimit të biznesit nga ana e Kryeqytetit, por vetëm përmbushje të detyrimit financiar për ushtrimin e veprimtarisë në territorin e tij.
- 5.Subjektet afariste që realizojnë pagesën e taksës përkatëse pajisen me Leje për ushtrimin e veprimtarisë afariste, e cila dëshmon vetëm përmbushjen e detyrimit për pagesën e taksës komunale dhe nuk përbën akt regjistrimi apo legjitimimi të biznesit.

Neni 7

Lirimet nga taksa komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste

1. Çdo subjekt afarist në vitin e parë të themelimit/regjistrimit të saj, pa marrë parasysh muajin e regjistrimit/themelimit, lirohet nga pagesa e taksës komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste.
2. Subjektet afariste të cilat shuhen do të lirohen nga pagesa e taksës për vitin fiskal në të cilin shuhen (lirohen për ata muaj të operimit brenda vitit fiskal).
3. Subjektet afariste të regjistruara në emër të grave dhe vajzave përfitojnë ulje prej 50% mbi tarifën e parashikuar dy vitet e para pas themelimit.
4. Për të përfituar këtë ulje, subjektet afariste janë të obliguara të parashtrojnë kërkesë pranë autoritetit përkatës, pas pranimit të faturës.

Neni 8

Tarifat komunale për veprimtaritë ekonomike

Nr	KATEGORITE AKTUALE	TAKSA	
		E propozuar	Aktuale
	ENERGJIA DHE SHERBIMET PUBLIKE		
3511	Prodhimi i rrymes elektrike	1000.00	1000.00
3600	Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë	1000.00	1000.00
	AUTOMJETE		
4511	Tregtia e veturave dhe automjeteve me fuqi motorike te vogel(te reja)	700.00	700.00
4511	Tregtia e veturave dhe automjeteve me fuqi motorike te vogel(te vjetra)	300.00	300.00
	KARBURANTE		
4730	Tregtia me pakicë e karburanteve per automjete	1000.00	1000.00

	(zona urbane)		
4730	Tregtia me pakicë e karburanteve per automjete (zona rurale)	500.00	500.00
BARNATORE			
4646	Tregtia me shumicë e artikujve farmaceutike	700.00	500.00
4773	Tregtia me pakicë e artikujve farmaceutike	500.00	250.00
HOTELERI			
5510	Hotelet	1000.00	1000.00
5510	Motelet	500.00	300.00
5510	Hostelet	300.00	300.00
Sektor Financiar dhe Telekomunikim			
6419	Ndërmjetësime të tjera monetare (bankat)	1000.00	1000.00
6419	Ndërmjetësime monetare (institucionet mikrofinanciare)	500.00	1000.00
6110	Veprimtaritë e telekomunikimit (rrjeti fiks dhe mobil)	1000.00	1000.00
6512	Sigurimi jojetësor	1000.00	1000.00
SIGURIA			
8010	Aktivitetet e sigurimit privat	300.00	300.00
8424	Rendi publik dhe aktivitetet e sigurisë	300.00	300.00
8020	Aktivitetet shërbyese të sistemeve të sigurimit	300.00	300.00
KATEGORITE E PROPOZUARA			
Ndërtimtari dhe Infrastrukturë			
4120	Ndërtimi i objekteve banesore dhe jobanesore	2000.00	
4211	Ndërtimi i rrugëve dhe autostradave	1000.00	
4322	Punime hidraulike, instalime të ngrohjes dhe kondicionimit të ajrit	300.00	
Automjete dhe Ndërmjetësim			
4520	Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve (auto serviset)	700.00	
4520	Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve	300.00	

	(autolarjet)		
4613	Ndërmjetësim për shitjen e drurit dhe materialeve te ndertimit	1000.00	
4615	Ndërmjetësim për mobilie, mallra shtëpiake, pajisje elektronike dhe hekurishteve	500.00	
4673	Tregtia me shumice e drurit, materialeve te ndertimit dhe paisjeve hidrosanitare	700.00	
1623	Prodhimi i karpentierisë dhe zdruktarisë tjetër ndërtuese		
3102	Prodhimi i mobileve të kuzhines		
TREGTI ME PAKICE			
4711	Tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuara (ushqim, pije, duhani) (kategorizim ne baze te m2 te lokalit)	300.00--	
4722	Tregtia me pakicë e mishit dhe produkteve të mishit në dyqane të specializuara	300.00	
4742	Tregtia me pakicë e pajisjeve të telekomunikimit	300.00	
4777	Tregtia me pakicë e orëve dhe argjendarisë	500.00	
4778	Tregtia me pakicë e mallrave të tjera të reja	400.00	
4752	Tregtia me pakicë e artikujve elektronikë, ngjyrave dhe xhamit, në dyqane të specializuara	500.00	
4759	Tregtia me pakicë e mobilieve, pajisjeve të ndriçimit dhe artikujve të tjerë shtëpiake, në dyqane të specializuara	500.00	
Transport dhe Logjistikë			
4939	Transporti tjetër rrugor i pasagjerëve	400.00	
5223	Aktivitete shërbyese të rastit për transportin ajror	500.00	
5320	Aktivitete të tjera postare dhe të ndërlidhjes	400.00	
7911	Aktivitetet e agjencive të udhëtimit,	400.00	
7912	Aktivitete të operatorëve turistikë	400.00	
Shërbime Profesionale			
6831	Agjenci të patundshmërive	700.00	
6910	Aktivitete juridike (Avokatët)	1000.00	
6910	Aktivitete juridike (Noterët)	1000.00	
6910	Aktivitete juridike (Përmbaruesit privat)	700.00	

6910	Aktivite juridike (Ndërmjetësuesit)	700.00	
6920	Kontabilitet, librëmbajtje dhe auditim	500.00	
7111	Aktivite të arkitekturës	500.00	
8220	Aktivite të qendrave të thirrjeve	2000.00	
ARSIMI			
8520	Arsimi fillor privat	1000.00	
8531	Arsimi i përgjithshëm i mesëm privat	1500.00	
8532	Arsimi i mesëm teknik dhe professional privat	1500.00	
8542	Arsimi i lartë privat	2000.00	
8553	Aktivite të autoskollave	300.00	
Shëndetësi			
8610	Aktivite të spitaleve private	3000.00	
8622	Aktivite të mjekësisë së specializuar private	3000.00	
8623	Aktivite të dentistëve	2000.00	
8690	Aktivite të tjera të shëndetit të njeriut	1000.00	
Sport dhe Estetikë			
9312	Aktivite te klubeve sportive	300.00	
9313	Palestra fitnesi	500.00	
9602	Sallonet e floktarise dhe trajtimet e tjera te bukurise	1000.00	
9604	Aktivitetet e mirëmbajtjes trupore	3000.00	
	Gjithsej		

KAPITULLI III

Neni 9

Taksat e akomodimit

1. Qytetarët e Republikës së Kosovës dhe të huajt që qëndrojnë gjatë natës në një strukturë akomoduese jashtë vendbanimit të tyre paguajnë taksën e akomodimit.
2. Taksa e akomodimit paguhet njëkohësisht me pagesën e akomodimit për një natë.
3. Taksa e akomodimit trajtohet si e hyrë vetenake e komunës dhe i destinohet promovimit dhe zhvillimit të turizmit në komunën përkatëse.
4. Taksa e qëndrimit paguhet në shumën prej **1 (një) euro për person për çdo natë**.
5. Subjektet që ushtrojnë veprimtari akomodimi janë të obliguara të mbledhin dhe paguajnë taksën e akomodimit sipas procedurave të përcaktuara nga komuna.
6. Subjektet obliguese për mbledhjen dhe pagesën e taksës për akomodim janë të gjitha njësitë që ofrojnë shërbim akomodimi brenda territorit të Kryeqytetit.
7. Taksa arkëtohet nga subjekti hotelier në momentin e pagesës së shërbimit të akomodimit.
8. Shuma e taksës paraqitet si pikë e veçantë në faturë.
9. Subjekti hotelier vepron si mbledhës i taksës në emër të Komunës.

Neni 10

Përfshirja nga taksa e akomodimit

1. Nga pagesa e taksës së akomodimit përjashtohen kategoritë si në vijim:
2. fëmijët nën moshën shtatë (7) vjeç;
3. personat me referim mjekësor që qëndrojnë në natyrë me qëllim të shërimit;
4. personat e siguruar për të cilët, sipas paraqitjes së fotokopjes së një vendimi të autoritetit kompetent, është e qartë se kanë aftësi të kufizuar ose dëmtim fizik, ose në bazë të një karte anëtarësimi të një organizate të aftësisë së kufizuar;
5. nxënësit, studentët, udhëheqësit ose mentorët e tyre, pjesëmarrësit në programet edukative të

organizuara nga shoqëritë dhe institucionet e tjera arsimore në baza jofitimprurëse ose nga komunitetet fetare dhe të tjera si pjesë e aktiviteteve të tyre të rregullta;

6. nxënësit në konviktet e shkollave dhe konviktet e studentëve;

7. personat të cilët punojnë përkohësisht dhe jetojnë në një objekt të industrisë ushqimore për më shumë se tridhjetë (30) ditë;

8. shtetasit e huaj të cilët janë të liruar nga taksa e akomodimit në përputhje me rregulloret dhe marrëveshjet ndërkombëtare;

1.8. anëtarët e shoqatave të cilët merren me aktivitete sportive, në bazë të një karte të vlefshme të anëtarësimit.

Neni 11

Raportimi në Kryeqytet

1. Subjektet hotelierike janë të obliguara që të raportojnë në Kryeqytet, në baza mujore, të dhënat si vijon:

1.1. numrin total të mysafirëve të akomoduar;

1.2. numrin e netëqëndrimeve;

1.3. shumën totale të taksës së arkëtuar.

2. Raportimi bëhet deri më datën 10 të muajit pasues për muajin paraprak.

2. Raporti dorëzohet në formë elektronike ose fizike në Sektorin e Zhvillimit të qëndrueshëm.

Neni 12

Pagesa e taksës

1. Shuma e taksës së arkëtuar derdhet në llogarinë bankare të Kryeqytetit brenda afatit të raportimit.
1. Pagesa bëhet një herë në muaj, së bashku me dorëzimin e raportit përkatës.

Neni 13

Mbikëqyrja dhe kontrolli

1. Drejtoria/Sektori kompetent kryen mbikëqyrjen e zbatimit të kësaj rregulloreje.
2. Subjektet hotelierike obligohen të sigurojnë qasje në evidencat dhe dokumentacionin përkatës gjatë kontrollit.

KAPITULLI IV

Neni 14

Taksa komunale për hyrje të automjeteve në territorin e Kryeqytetit

1. Me këtë rregullore përcaktohet taksa komunale për hyrjen e automjeteve në territorin administrativ të Kryeqytetit.
2. Çdo automjet i regjistruar jashtë territorit të Kryeqytetit, që hyn në zonën e përcaktuar nga Kryeqyteti, i nënshtrohet pagesës së taksës në shumën prej 10 (dhjetë) euro për hyrje.
3. Pagesa e taksës realizohet:
 - 3.1. përmes pikave të autorizuara hyrëse;
 - 3.2. përmes sistemit elektronik të pagesës;

3.3. ose përmes platformave të tjera të miratuara nga Kryeqyteti.

4. Përfshihen nga pagesa e kësaj takse:

4.1. automjetet e shërbimeve emergjente (ambulanca, zjarrfikës, polici);

4.2. automjetet e institucioneve publike në kryerje të detyrës zyrtare;

4.3. banorët rezidentë të Kryeqytetit (me dëshmi të vlefshme);

4.4. kategoritë e tjera të përcaktuara me vendim të veçantë të Kryetarit të Kryeqytetit.

5. Mos-pagesa e taksës përbën kundërvajtje dhe sanksionohet me gjobë në përputhje me legjislacionin në fuqi, me Neni 15 të kësaj rregulloreje.

6. Drejtoria kompetente përdhe ajo caktojnë zonat e aplikimit dhe mënyrën e kontrollit të zbatimit të kësaj takse.

KAPITULLI V

Neni 15

Autorizimet e Drejtorisë së Inspektionit

1. Drejtoria e inspektionit është kompetente për mbikëqyrjen dhe kontrollin e zbatimit të kësaj rregulloreje.

2. Inspektori i Kryeqytetit pas evidentimit se një subjekt afarist operon pa Leje për ushtrim veprimtarie afariste, njofton subjektin afarist për veprimet të cilat duhet ti ndër marr për tu pajisur me Lejën për ushtrimin e veprimtarisë afariste brenda afatit kohor prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, nga momenti i pranimit të procesverbalit nga inspektori.

3. Nëse subjekti afarist nuk e respekton këtë afat për tu pajisur me Lejën për ushtrimin e veprimtarisë afariste, Inspektori i Kryeqytetit obligohet të shqiptoj gjobën në vlerën prej 30% të vlerës së taksës për ushtrimin e veprimtarisë afariste, të cilën është i obliguar ta paguaj sipas kësaj rregulloreje

4. Në rastet kur, subjekti afarist nuk pajiset me Leje për ushtrim të veprimtarisë, të njëjtit obligohet t'i shqiptohet gjoba për herën e dytë në vlerë prej 50% të vlerës së taksës për ushtrimin e veprimtarisë afariste, të cilën është i obliguar ta paguaj sipas kësaj rregulloreje.

5. Nëse edhe pas shqiptimit të gjobave sipas pikave 3 dhe 4 të këtij neni, subjekti afarist nuk pajiset me Leje për ushtrim të veprimtarisë afariste të njëjtit Inspektori i Kryeqytetit obligohet t'i ndalojë kryerjen e veprimtarisë afariste në kohëzgjatje më së shumti prej 8 ditësh.

6. Për të gjitha procedurat e shqiptimit të gjobave, mënyrës dhe afatave të pagesës së gjobave, si dhe procedurave tjera lidhur me gjobat të cilat nuk janë rregulluar me dispozitat e kësaj rregulloreje, vlejné dispozitat e Ligjit për kundërvajtje.

KAPITULLI VI

Neni 16

Dispozitat shfuqizuese dhe kalimtare

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohen të gjitha dispozitat e Nenit 2, pika 3 e Rregullorës për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale nr.01-110-2782 e dt. 01.12.2011, Vendimi për ndryshimin e Rregullorës për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale nr. 01-110-21449 i dt. 28.02.2013, Vendimi nr. 01-431/04-112314/21 i dt. 16.06.2021 si dhe Vendimi nr. 01-431/04-185458/21 i dt. 03.09.2021 të cilët përfshijnë taksat për ushtrimin e veprimtarisë afariste.

2. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet Vendimi për shqyrtimin e ankesave lidhur me ngarkesat vjetore për ushtrimin e veprimtarisë afariste, 14-020/04-0299221/19 i datës 09.12.2019.

3. Prej momentit të hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje do të aplikohen tarifat e përcaktuara në këtë rregullore.

Neni 17

Hyrja në fuqi

1. Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.